



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 212

Tiranë – E enjte, 10 nëntor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 9779, datë 31.10.2016	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 22417
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 763, datë 2.11.2016	Për përcaktimin e ngjyrës, shenjave dhe përdorimin e mjeteve të Policisë së Shtetit..... 22417
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 764, datë 2.11.2016	Për nxjerrjen në shitje të disa mjeteve të transportit të rëndë, të grupit A, të kaluara në favor të shtetit si pasojë e konfiskimit..... 22442
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 769, datë 2.11.2016	Për një shtesë në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar..... 22443
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 771, datë 2.11.2016	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 276, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien në përdorim të përkohshëm, nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, të pronës nr. 33, me emërtim “Shtëpia e Ushtrakëve”, me vendndodhje në bulevardin “Zhan D’Ark”, Tiranë, për vendosjen e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR), Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Markave dhe Patentave (DPPM) e Agjencisë së Zbatimit të Reformës Territoriale (AZRT)”, të ndryshuar..... 22444
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 772, datë 2.11.2016	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, në cilësinë e organit të interesuar, për pagesën e faturave të avokatëve të kontraktuar për përfaqësimin dhe mbrojtjen në çështjet e Arbitrazhit Ndërkombëtar ICC, nr. 20564/EMT Hydro S.R.L. kundër Republikës së Shqipërisë dhe ICSID, nr. ARB/15/28 Hydro S.R.L. & Others kundër Republikës së Shqipërisë, dhe çdo shpenzimi tjetër të lidhur me to..... 22445

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 775, datë 2.11.2016	Për përcaktimin e masës së financimit, nga buxheti i vitit 2016, për Kishën Katolike në Shqipëri, me rastin e Lumturimit të Martirëve Shqiptarë.....	22446
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 780, datë 2.11.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Ndërhyrje rehabilituese në zonën e mbrojtur të Qendrës Historike të Dhërmiut”.....	22446

**DEKRET**

Nr. 9779, datë 31.10.2016

**PËR LEJIMIN E LËNIES
SË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Arta Brahim Loshi (Bilaj)
2. Limoz Ilia Pali
3. Chrissa Margarete Ardian Nako
4. Xhesika Kujtim Hoxha
5. Rado Ilo Stajkiq (Llazoja)
6. Adrian Selim Zagori
7. Eula Xhevdet Zagori (Mahilaj)
8. Ben Adrian Adrian Zagori
9. Hereida Bardhyl Dani
10. Ledjona Agron Dulaj
11. Megan Stavri Reveli
12. Rozeta Skënder Kaloshi
13. Fazli Afrim Mulaj
14. Mirela Fetah Luparello (Xhaxhaj)
15. Silva Ferdinand Naço
16. Brita Dodë Dakaj
17. Anila Mas-har Börger (Kunxholli)
18. Alfred Sefulla Mersini
19. Migena Bajram Mersini (Lile)
20. Paula Alfred Mersini
21. Jetart Alfred Mersini
22. Helly Elisabeth Alfred Mersini
23. Fatbardha Shaban Dizdari (Matoshi)
24. Andreas Fadil Serjani
25. Gligo Llazo Zlatičanin (Kerstoja)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

VENDIM

Nr. 763, datë 2.11.2016

**PËR PËRCAKTIMIN E NGJYRËS,
SHENJAVE DHE PËRDORIMIN E
MJETEVE TË POLICISË SË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit nr. 100, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Policia e Shtetit në ushtrimin e funksioneve të saj përdor mjete lëvizëse të uniformuara dhe të pauniformuara, të ndara në:

- a) mjete rrugore;
- b) mjete lundruese.

2. Mjetet e uniformuara rrugore dhe lundruese, në përdorim të strukturave dhe të punonjësve të Policisë së Shtetit, kanë:

- a) ngjyrë, disenjo dhe numër telefoni, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;
- b) pajisje sinjalizuese pamore dhe zanore me specifikimet teknike, sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Lloji i mjeteve të uniformuara sipas strukturave të Policisë së Shtetit, është sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Ngjyra, logoja dhe targat, në mjetet e uniformuara të Policisë së Shtetit, janë unike dhe me të drejtë përdorimi vetëm nga Policia e Shtetit.

5. Targa e mjeteve rrugore të Policisë së Shtetit është sipas legjislacionit në fuqi.

6. Mjetet e pauniformuara kanë logo dhe pajisje sinjalizuese portative.

7. Të gjitha mjetet e Policisë së Shtetit janë të kompletuara me pajisje speciale për sigurimin e jetës dhe realizimin e detyrës.

8. Mjetet e Policisë së Shtetit përdoren vetëm për nevoja pune dhe në funksion të përmbushjes së detyrës.

9. Drejtori i Policisë së Shtetit, miraton me urdhër të tij:

Lidhja nr.1

NGJYRA DHE DISENJO E MJETEVE TË UNIFORMUARA TË POLICISË SË SHETËTIT

• Mjetet e Policisë Rrugore:

1. Autoveturë tërheqja 2x4 (faqe nr. 1, e katalogut)

- Ngjyra e automjetit e bardhë.
 - Flamuri kombëtar me përmasa 14x7 cm në pjesën e sipërme të dy parafangove.
 - Stema e Policisë së Shtetit (3 copë) me material adeziv fosforishent në të dyja portat e para dhe në qendër të kapakut të motorit.
 - Shirit blu që fillon nga pjesa e përparme mbi parakolp dhe përfundon në pjesën e pasme në kufi me portën e bagazhit duke u ndërprerë në portën e parë nga stema “POLICIA E SHETËTIT”.
 - Në pjesën e dytë të shiritit blu pas stemës “POLICIA E SHETËTIT” mbishkrimi “POLICIA RRUGORE” me ngjyrë të bardhë.
 - Numri i mjetit policor i dukshëm në pjesën e sipërme me ngjyrë blu dhe në shirit mbi gomën e parë me ngjyrë të bardhë.
 - Numri i telefonit të policisë në dy pjesët anësore të prapakolpit.
 - Në xhamin e pasëm tabelë elektronike portative me komandat “NDAL POLICIA” dhe “MË NDIQ”.
- Në pjesën e pasme poshtë targës mbishkrimi “POLICIA” blu fosforishente.

ZËVENDESKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

DIZENJIMI I MJETEVE
TE POLICISE SE SHETËTIT



POLICIA RRUGORE FAQE NR.1

2. Motoçikleta për Policinë Rrugore (Faqe nr.2, e katalogut)

- Ngjyra e motoçikletës e bardhë.
- Flamuri kombëtar me përmasa 14x7 cm në pjesën e sipërme të dy parafangove.
- Stema e Policisë së Shtetit me material adeziv fosforishent në xhamin parapritës.
- Shirit blu që fillon në serberator (Depozita e karburantit) dhe përfundon në fund të çantave anësore duke u ndërprerë në pjesën e ndenjës së drejtuesit.
- Në pjesën e dytë të shiritit blu mbi çantat anësore mbishkrimi “POLICIA RRUGORE” me ngjyrë blu e të bardhë.
- Numri telefonit të policisë në dy pjesët anësore të çantave.

DIZENJIMI I MJETEVE TE POLICISE SE SHTESTIT



MOTOÇIKLETA E POLICISE RRUGORE FAQE NR.2

• Mjetet e skuadrës “Shqiponja”

1. Autoveturë për patrullim tërheqja 2x4 (Faqe nr.3, e katalogut)

- Ngjyra e automjetit e bardhë.
- Flamuri kombëtar me përmasa 14x7 cm në pjesën e sipërme të dy parafangove.
- Stema e skuadrës “Shqiponjat” (3 copë) me material adesiv fosforishent në të dy portat e para dhe në qendër të kapakut të motorit.
- Shirita blu dhe portokalli që fillojnë nga pjesa e përparme mbi parakolp dhe përfundojnë në pjesën e pasme në kufi me portën e bagazhit.
- Në të dy anët pas stemës “Shqiponjat” me ngjyrë blu mbishkrimi “POLICIA”
- Numri telefonit të policisë në dy pjesët anësore të prapakolpit.
- Në pjesën e pasme poshtë targës stema e skuadrës “Shqiponjat” dhe mbishkrimi “POLICIA” blu fosforeshente.

DIZENJIMI I MJETEVE
TE POLICISE SE SHTETIT



Të gjitha matjet janë në milimetra

■ C-0 M-80 Y-100 K-0 Adeziv fosforeshent
 ■ C-100 M-65 Y-0 K-0 Adeziv fosforeshent

SKUADRA SHQIPONJAT FAQE NR.3

2. Motoçikleta për skudarën "SHQIPONJAT" (Faqe nr.4, e katalogut)

- Ngjyra e motoçikletës e bardhë.
- Flamuri kombëtar me përmasa 14x7 cm në pjesën e sipërme të dy parafangove.
- Stema e skuadrës "Shqiponjat" me material adesiv fosforishent në xhamin parapritës.
- Shirit blu që fillon në serberator (Depozita e karburantit) dhe përfundon në fund të çantave anësore duke u ndërprerë në pjesën e ndenjës së drejtuesit.
- Në pjesën e dytë të shiritit blu mbi çantat anësore mbishkrimi "POLICIA" me ngjyrë të bardhë.
- Numri telefonit të policisë në dy pjesët anësore të çantave.

DIZENJIMI I MJETEVE
TE POLICISE SE SHTETIT



SKUADRA SHQIPONJAT (MOTOÇIKLETA) FAQE NR.4

3. Minibus për patrullim. (Faqe nr.5, e katalogut)

- Ngjyra e automjetit e bardhë
- Flamuri kombëtar me përmasa 14x7 cm në pjesën e sipërme të dy paraqangove.
- Stema e skuadrës “Shqiponjat” (3 copë) me material adhesiv fosforishent në të dy portat e para dhe në qender të kapakut të motorit.
- Shirita blu dhe portokalli në pjesën fundore të kabinës dhe e mesit të kabinës që fillojnë nga feneri i parë dhe përfundojnë në pjesën e pasme në kufi me portën e bagazhit.
- Mbi pjesën e bardhë anësore pas stemës “Shqiponjat” me ngjyrë blu mbishkrimi “POLICIA”.
- Numri i telefonit të policisë në dy pjesët anësore të prapakolpit.
- Në pjesën e pasme sipër targës stema e skuadrës “Shqiponjat” dhe mbishkrimi “POLICIA” me ngjyrë blu fosforishente.

**DIZENJIMI I MJETEVE
TE POLICISE SE SHTETIT**

Të gjitha matjet janë në milimetra

FUGONI I SHQIPONJAVE FAQE NR.5

• **Mjetet e Shërbimeve të Rendit:**

1. Autoveturë për patrullim tërheqja 2x4 (Faqe nr.6, e katalogut)

- Ngjyra e automjetit e bardhë.
- Flamuri kombëtar me përmasa 14x7 cm në pjesën e sipërme të dy parafangove.
- Stema e Policisë së Shtetit (3 copë) me material adesiv fosforishent në të dy portat e para dhe në qendër të kapakut të motorit.
- Shirit blu që fillon nga pjesa e përparme mbi parakolp dhe përfundon në pjesën e pasme në kufi me portën e bagazhit duke u ndërprerë në portën e parë nga stema e “POLICIA E SHETIT”.
- Në pjesën e dytë të shiritit blu pas stemës “POLICIA E SHETIT” mbishkrimi “POLICIA” me ngjyrë të bardhë.
- Numri telefonit të policisë në dy pjesët anësore të prapakolpit.
- Në pjesën e pasme poshtë targës mbishkrimi “POLICIA” blu fosforeshente.

**DIZENJIMI I MJETEVE
TE POLICISE SE SHETIT**



Të gjitha matjet janë në milimetra

POLICIA E RENDIT FAQE NR.6

2. Motoçikleta (Faqe nr.7, e katalogut)

- Ngjyra e motoçikletës e bardhë.
- Flamuri kombëtar me përmasa 14x7 cm në pjesën e sipërme të dy parafangove.
- Stema “POLICIA E SHETËTIT” me material adesiv fosforishent në xhamin parapritës.
- Shirit blu që fillon në serberator (Depozita e karburantit) dhe përfundon në fund të çantave anësore duke u ndërprerë në pjesën e ndenjës së drejtuesit.
- Në pjesën e dytë të shiritit blu mbi çantat anësore mbishkrimi “POLICIA” me ngjyrë të bardhë.
- Numri telefonit të policisë në dy pjesët anësore të çantave.

DIZENJIMI I MJETEVE TE POLICISE SE SHETËTIT



POLICIA E RENDIT (MOTOÇIKLETA) FAQE NR.7

3. Minibus për patrullim. (Faqe nr.8, e katalogut)

- Ngjyra e automjetit e bardhë.
- Flamuri kombëtar me përmasa 14x7 cm në pjesën e sipërme të dy parafangove.
- Stema “POLICIA E SHTETIT” (2 copë) me material adhesiv fosforishent në të dy portat e para.
- Stema e “Policisë së Rendit” në qendër të kapakut të motorit dhe në pjesën e pasme para mbishkrimit “POLICIA”.
- Shirita blu në pjesët anësore që fillojnë nga kufiri i portës së parë dhe përfundojnë në pjesën e pasme në kufi me portën e bagazhit.
- Në pjesët anësore me ngjyrë blu mbishkrimi “POLICIA”.
- Numri i telefonit të policisë në dy pjesët anësore të prapakolpit.
- Në pjesën e pasme sipër targës mbishkrimi “POLICIA” me ngjyrë blu fosforishente.

**DIZENJIMI I MJETEVE
TE POLICISE SE SHTETIT***Te gjitha matjet janë në milimetra*

MINIBUS PER POLICINE E RENDIT FAQE NR.8

4. Autoveturë me kalueshmëri të lartë. (Faqe nr.9, e katalogut)

- Ngjyra e automjetit e bardhë.
- Flamuri kombëtar me përmasa 14x7 cm në pjesën e sipërme të dy parafrangove.
- Stema “POLICIA E SHTETIT” (2 copë) me material adesiv fosforishent në të dy portat e para.
- Stema “POLICIA E RENDIT” në qendër të kapakut të motorit dhe në pjesën e pasme të automjetit.
- Në pjesën e dytë pas stemës “POLICIA E SHTETIT” mbishkrimi “POLICIA” me ngjyrë blu fosforishente mbi sfond të bardhë.
- Numri i telefonit të policisë në dy pjesët anësore të prapakolpët.
- Në pjesën e pasme mbishkrimi “POLICIA” blu fosforishente .

DIZENJIMI I MJETEVE
TE POLICISE SE SHTETIT



Të gjitha matjet janë në milimetra


FUORISTRADË PER POLICINE E RENDIT FAQE NR.9

• **Mjetet e Policisë Kufitare dhe Migracionit:**

1. Autoveturë me kalueshmëri të lartë (Fuoristrada). (Faqe nr.10, e katalogut)

- Ngjyra e automjetit e bardhë.
- Flamuri kombëtar me përmasa 14x7 cm në pjesën e sipërme të dy parafangove.
- Stema “POLICIA E SHETËTIT” (2 copë) me material adesiv fosforishent në të dy portat e para.
- Stema “POLICIA KUFITARE” në qendër të kapakut të motorit dhe në pjesën e pasme të automjetit.
- Shirit blu që fillon nga pjesa e përparme mbi parakolp dhe përfundon në pjesën e pasme në kufi me portën e bagazhit duke u ndërprerë në portën e parë nga stema e “POLICIA E SHETËTIT”.
- Në pjesën e dytë të shiritit blu pas stemës “POLICIA E SHETËTIT” mbishkrimi “POLICIA” me ngjyrë blu fosforishente mbi sfond të bardhë.
- Numri i telefonit të policisë në dy pjesët anësore fundore mbi shiritin blu.

**DIZENJIMI I MJETEVE
TE POLICISE SE SHETËTIT**



Të gjitha matjet janë në milimetra

POLICIA KUFITARE FAQE NR. 10

2. Minibus për patrullim në brezin kufitar. (Faqe nr.11, e katalogut)

- Ngjyra e automjetit e bardhë.
- Flamuri kombëtar me përmasa 14x7 cm në pjesën e sipërme të dy parafangove.
- Stema “POLICIA E SHETËTIT” (2 copë) me material adesiv fosforishent në të dy portat e para.
- Stema “POLICIA KUFITARE” në qendër të kapakut të motorit dhe në pjesën e pasme të automjetit..
- Shirita blu që fillojnë nga feneri i parë dhe përfundojnë në pjesën e pasme në kufi me portën e bagazhit.
- Në mes të shiritave blu mbishkrimi “POLICIA” ngjyrë blu me material fosforishent.
- Numri i telefonit të policisë me ngjyrë blu, në dy pjesët anësore pas mbishkrimit “POLICIA”, dhe në pjesën e pasme.
- Në pjesën e pasme sipër targës mbishkrimi “POLICIA” me ngjyrë blu fosforishente.

**DIZENJIMI I MJETEVE
TE POLICISE SE SHETËTIT**

Të gjitha matjet janë në milimetra

FUGONI I KUFIRIT FAQE NR.11

3. Mjete lundruese për patrullim në det dhe liqen.

- Ngjyra e mjetit e bardhë.
- Stema e flamurit kombëtar me përmasa 14x7 cm në pjesën e sipërme të bashit para.
- Flamuri kombëtar me përmasa 140x70 cm në pjesën e sipërme në vendin më të dukshëm.
- Në mes të pamjes anësore në të dy krahët stema “POLICIA E SHTETIT” (2 copë) me material adesiv fosforishent.
- Në pjesën e parë anësore në të dy anët para ose pas stemës “POLICIA E SHTETIT” dy shirita të pjerët me ngjyrë të kuqe dhe blu.
- Në të dy anët mbishkrimi “POLICIA KUFITARE” me ngjyrë blu fosforishent.
- Në pjesën fundore të bashit sipër në të dy anët, numri telefonit të policisë me ngjyrë blu.

DIZENJIMI I MJETEVE TE POLICISE SE SHTETIT



Të gjitha matjet janë në milimetra

POLICIA KUFITARE FAQE NR.12

Lidhja nr.2

SINJALISTIKA PAMORE E MJETEVE RRUGORE TË POLICISË SË SHTETIT**• Automjetet e Policisë Rrugore.**

1. Fenelinë profesionale për autoveturat me ndricim LED anash (ngjyrë BLU), me sinjalizues zanor sipas këtyre parametrave teknikë:

- Të jenë të homologuara dhe të plotësojnë të gjitha parametrat teknikë të kërkuara nga normativat e BE-së dhe ato të Policisë së Shtetit shqiptar, si vijon:
- Të dy pjesët anësore të jenë njëra ngjyrë blu, ndërsa pjesa e mesit të jetë me sinjalizues zanorë pas dhe me tabelë njoftimi/lajmërimi LED në pjesën balllore.
- Ndriçimi : LED me 130 ± 10 pulsime në minutë, me 4 module me nga 18 llampa .
- Sirena/altoparlant jo më pak se dy copë (pjesë përbërëse e fenelinës) për emergjencë dhe lajmërim/foni zëri.
- Njësi komand qendrore për ndriçimin dhe fonin për Policinë e Shtetit.
- Pasqyrë alumini e anodizuar.
- Mundësi sinkronizimi të 2 grupeve ndriçuese.
- Të ketë tregues sigurie IP jo më të vogël se 50.
- Të ketë rezistencë pune në temperaturë -30 deri në +50 gradë Celcius.
- Të ketë rezistencë ndaj kushteve klimaterike, veçanërisht ujit/shiut.
- Sistemi i ushqimit: 12V – DC.
- Forma dhe dimensionet e pajisjes kërkohet të jenë jo më të mëdha se ato të treguara në figurën e mëposhtme:



2. *Pajisjet e sistemit sinjalizues për MOTOÇIKLETA* me LED, vezullues si dhe llamba e pasme teleskopike me këto specifikime teknike:




Karakteristikat teknike të sinjalistikës FLI LD 180.

V12		IP 55	$^{\circ}\text{C } -40+65$	On ∞
		Flash/min		A
ECE R 65 pending		130 ± 10	LED	V12:
ECE R65 pending		130 ± 10	LED	1.5 A max
EMC 2006/28/CE pending			12V	

Pajisje ballore me formë të rrumbullakosur me 9 LED dhe optike dytësore për shpërndarjen e dritës në 180° , e tillë që pajisjet e montuara në motor të rezultojnë të pashme nga kënde të ndryshme.


Qark elektronik i integruar në pjesën e prapme të pajisjes.

Përmasat e pajisjeve sinjalizuese me LED.



Karakteristika teknike, forma dhe përmasat e llambës teleskopike.

Përmasat e llambës teleskopike me dy hapje.



2 hapje (h 1035 mm); kg 1.64

Karakteristikat teknike të llambës së pasme teleskopike(stroboskopike).

V 12 ÷ 24		IP 66	⁰ C -30+50	On ∞	
			r.p.m.		A
ECE R 65 TB1 E ₃ 00 7070	130 ±10	130±10	LED	V12: 0.9 A V24: 0.45 A	
ECE R65 TA1 E ₃ 00 7070	130 ±10	130±10	LED		
EMC 2006/28/CE e3 03 1184		12V	BV		
		Flash/min		A	
ECE R65 TB1 E ₉ 00 1320		130±10	8X LED	V12: 1.7 A V24: 0.8 A	
ECE R65 TA1 E ₃ 00 7105		130±10	8X LED		
ECE R65 TR1 E ₃ 00 7105		130±10	8X LED		
EMC 2006/28/CE e3 03 1201			BV		

Llambë teleskopike, manuale me dalje drite e përbëre nga 8 LED, me kupole me material polikarbonatë.

Dalja e dritës me LED është e disponueshme me efekt rrotullues (Crystal LED SPT Moto) ose me efekt flash (Crystal 8X LED SPT Moto).

- **Për automjetet e Policisë së Rendit.**

1. **Fenelinë pamore profesionale për autoveturat e Policisë së Shtetit** me ndriçim rrotullues anash ngjyrë blu dhe mbishkrimin në mes “POLICIA”.

Këto pajisje janë të homologuara dhe duhet të plotësojnë të gjitha parametrat teknikë të kërkuara nga normativat e BE-së dhe ato të Policisë së Shtetit Shqiptar, si vijon;


- Të ketë grup optik R LED (efekt rrotullues)
- Të ketë 8 LED të ushqyera nga 2 ushqyes *switching*, të cilët të jenë të montuar mbi një qark të stampuar me bazë alumini, i fiksuar në një suport të gjatë tip lavaman alumini në formë qarkore.
- Të ketë lente reflektuese (PMMA) për përhapjen dhe amplifikimin e dritës në 360 gradë.
- Të dy pjesët anësore të jenë ngjyrë blu ndërsa pjesa e mesit të jetë e bardhë me ndriçim nga brenda, i cili të jetë i komandueshëm sipas rastit me mbishkrimin “POLICIA”.
- Transmision i përbërë prej çift koronash të dhëmbëzuara.
- Motoreduktor me filtër të brendshëm kundër zhurmave.
- Llambat e ndricimit të grupit të rrotullimit të jenë tipi H1.
- Rrotullim me bronxinë të sinterizuar.
- Pasqyrë alumini e anodizuar.
- Mundësi sinkronizimi të 2 grupeve rrotulluese.
- Forma, mbishkrimi dhe dimensionet e pajisjes janë sipas figurës së mëposhtme:



2. **Fenelinë pamore për autoveturat e skuadrës “SHQIPONJAT”;**


- Baza të jetë prej polikarbonati të pathyeshëm.
- Të ketë qark elektronik me besueshmeri të lartë.
- Tub shkarkimi për xeno 14J.
- Kupolë e brendshme të jetë prej lente Fresnel – PC.

- Kupolë e jashtme të jetë ngjyre blu, vet pastruese – PC.
- Bivoltazh 12-24V.
- 1F-2F-3F e seleksionueshme.
- E sinkronizueshme deri në 8 drita.
- E përbërë nga kontroll elektronik automatik me shkarkim të shpejt kondesatori (në 3"-5") dhe me LED kontroll ushqimi.
- Pesha të jetë jo më shumë se 0.85 kg.
- Dimensionet të jenë sipas figurës së mëposhtme (në mm).



3. **Fenelinë pamore për minibusët e Policisë së Rendit**
 - Tensioni i punës 12-24 V, me rrymë të vazhduar.
 - Shkalla e mbrojtjes IP 55.
 - Temperaturat min-max të funksionimit °C -30 +50.
 - Pesha jo më e madhe se 1.0 kg.
 - Rrotullime në minutë jo më pak se 130±10.
 - Materiali i kupolës Termoplatik Transparent dhe Polikarbonat.


- Baza e sipërme prej najloni të përforcuar me fibër xhami në PVC.
- Baza e poshtme prej najloni të përforcuar me fiber xhami.
- Paketë elektronike me besueshmeri të lartë.
- Tubo shkarkimi prej ksenoni 10 J.
- Pjesa e brendshme e kupolës lente tip Fresnel me material Termoplastik Transparent.
- Kupolë e jashtme e padepërtueshme material polikarbonat – montimi në forme bajonetë.
- Të ketë ndriçim në forme flash doppio në ngjyre blu.
- Dimensionet të treguara në figurën e mëposhtme.



4. **Fenelinë pamore emergjence** për Policinë në formë pikë loti me ndriçim *FLASH*

- Baza të jetë magnetike me qëndrueshmëri të lartë.
- Resistenca për shpejtësi mbi 200 km/h.
- Baza të jetë prej gome me anësore kundra gërvishjeve.
- Kupola të jetë prej polikarbonat të pathyeshëm – e fiksuar me vida.
- Të ketë bazë magnetike me 2 magnetë të sheshta prej neodimiumi të veshuara nga një guarnicion gome.
- Forma të jetë aerodinamike (sipas figurës mëposhtë) dhe e parrëshqitshme.

- Qark elektronik i kolauduar individualisht.
- Tub shkarkimi e xeno 8J.
- Kupolë e brendshme prej lente Fresnel – PMMA.
- Kupolë e jashtme e pathyeshme PC – montimi me vida.
- Versioni *flash* çift në formë bajonete.
- Kavo 4.5m me spinë që vendoset të ndezësi i cigareve ose spinë jack mono 6.35mm
- Peshë jo më shumë se 1.03 kg
- Dimensionet të jenë sipas figurës së mëposhtme (në mm)



SINJALISTIKA ZANORE E MIJTEVE TË POLICISË SË SHTETIT

- Sistem elektropneumatik dyzërësh i përbërë nga kompresori lubrifikues dhe një çift tytash.
- Frekuenca e zërit :

Toni i ulët = 466Hz

Toni i lartë = 622 Hz

- Renditja e zërit të jetë e barabartë: 50% toni lartë dhe 50% toni ulët.
- Numri i cikleve në minutë të jetë 60 cikle/minutë.
- Tyta të kromuara dhe të mbërthyer me bokolla me vidhosje, për vendosje të brendshme dhe të jashtme në mjet.




- Mbrojtes i çmontueshëm kundra mizave dhe insekteve.
- Kompresor lubrifikues i jashtëm i vidhosur/i ndërrueshëm.
- Konsum korrenti maksimumi 20A.
- Pesha maksimale e kompresorit 1300g.
- Tensioni CC 12V.
- Punimi i vazhdueshëm (pa ndërprerje) në temperatura 20°C minimumi 20 minuta pa ftohje të detyrueshme

KONFORMITETI;

- Të jenë të homologuara me sitemin R10.
- Të jenë të prodhuara nga kompani prodhuese të certifikuara sipas sistemit AUTOMOTIV ISO/TS 16949.


1. Kompresor për zë të fuqishëm dhe të drejtuar me këto parametra teknik;

Voltazhi nominal	12 -> 24 V
Voltazhi përdorimit	11.5-13.8 -> 23-27.6 V
Konsumi	17 -> 8 A
Presioni prodhuar	> 1 bar
Cikël në minutë	60
Temperaturë e përdorimit	-30 -> +60 grade C
Temperaturë e qëndrimit	-30 -> +80 grade C
Rezistenza ndaj korrozionit	> 96 ore
Lagështirë gjatë përdorimit	30 -> 80 %
Punimi me lubrifikim	> 30 min
Punimi pa lubrifikim	10 min
Izolimi elektrik	1000 V
Vibriimi	1 g
Pesha	1200 + 247 gr



2. Tyta për vendosje të brendshme në mjet me këto parametra teknik:

Niveli zërit	117 (2m) dB(A)
Frekuenca e ulët	466 Hz
Frekuenca e lartë	622 Hz
Presioni prodhuar	0.4 -> 2 bar
Cikël në minutë	60
Temperaturë e përdorimit	-30 -> +80 grade C
Temperaturë e qëndrimit	-30 -> +80 grade C
Rezistenca ndaj korrozionit	> 96 ore
Lageshtirë gjatë përdorimit	30 -> 80 %
Rezistenca	100 cikle
Punimi vazhdueshëm	60 min
Vibrimi	1 g
Pesha	790 gr





Lidhja nr. 3

LLOJET E MJETEVE TË UNIFORMUARA SIPAS STRUKTURAVE

Policia Rrugore:

- Autoveturë tërheqja 2x4 me min. 4+1 vende dhe min. 4 porta.
- Motoçikleta me 1+1 vende dhe min. 500 cc
- Mjete speciale për shërbimet e qarkullimit. (Mjet me pajisje speciale për raste aksidentesh)

Skuadra “Shqiponjat”:

- Autoveturë për patrullim tërheqja 2x4 me min. 4+1 vende dhe min. 4 porta.
- Minibus (Autoveturë me 8+1 vende) tërheqja 2x4 dhe min. 4 porta.
- Motoçikleta me 1+1 vende dhe min. 350 cc.

Shërbimet e Rendit:

- Autoveturë për patrullim tërheqja 2x4 me min. 4+1 vende dhe min. 4 porta.
- Autoveturë me kalueshmëri të lartë tërheqja 4x4 me min 4+1 vende dhe min. 4 porta.
- Minibus (Autoveturë me 8 +1 vende) tërheqja 2x4 dhe min. 4 porta.
- Motoçikleta me 1+1 vende dhe min. 250 cc.

Shërbimet e Forcës Lëvizëse Operacionale:

- Autoveturë me kalueshmëri të lartë tërheqja 4x4 me min 4+1 vende dhe min. 4 porta.
- Minibus (Autoveturë me 8+1 vende) me kalueshmëri të lartë, tërheqja 4x4 dhe min. 4 porta.
- Autobus me min 19+1 vende.
- Mjete speciale:
- Autoveturë me kalueshmëri të lartë, me nivel të mesëm blindimi, me tërheqje 4x4 dhe me min. 4+1 vende.
- Minibus me kalueshmëri të lartë, me tërheqje 4x4 dhe me min. 8+1 vende.

Shërbimet e Kufirit dhe Migracionit:

- Autoveturë me kalueshmëri të lartë tërheqja 4x4 me min 4+1 vende dhe min. 4 porta.
- Minibus (Autoveturë me 8+1 vende) me kalueshmëri të lartë, tërheqja 4x4 dhe min. 4 porta.
- Mjete lundruese:
- Gomone me min. dy motorë portative me min. 250 Hp secili.
- Motoskaf për patrullim në det me min. dy motorë me fuqi min 300 Hp secili.
- Motoskaf për patrullim në liqen me min. dy motorë me fuqi min 250 Hp secili.

**VENDIM****Nr. 764, datë 2.11.2016**

**PËR NXJERRJEN NË SHITJE TË DISA
MJETEVE TË TRANSPORTIT TË
RËNDË, TË GRUPIT A, TË KALUARA
NË FAVOR TË SHTETIT SI PASOJË E
KONFISKIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr. 9900, datë 10.4.2008, “Për rezervat materiale të shtetit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit (DPRMSH) për të realizuar shitjen me ankand publik të mjeteve të transportit të rëndë, që plotësojnë kushtet për qarkullim, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. DPRMSH-ja, për llogaritjen e vlerës së mjetit të transportit që plotëson kushtet për qarkullim, i cili do të dalë në ankand, sipas pikës 1 të këtij vendimi, do t'i referohet tabelës së dërguar nga zyra doganore, e cila ka përdorur si burim informacioni buletinet që pasqyrojnë çmimet e shitjes në tregjet evropiane. Vlerës së gjendur në tabelë i zbritet 50%, si koeficient amortizimi, për shkak të përdorimit të mjetit në territorin e Republikës së Shqipërisë. Vlera e

mbetur është vlera e mjetit të transportit, e cila do të jetë edhe vlera fillestare e ankandit.

3. Për mjetet e kategorizuara për qarkullim, të cilat nuk janë shitur pasi u janë nënshtruar procedurave të shitjes me ankand publik për tre herë me radhë, DPRMSH-ja vijon me procedurat e trajtimit për skrap dhe njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Transportit Rrugor për heqjen nga qarkullimi dhe çregjistrimin e këtyre mjeteve.

4. DPRMSH-ja lejohej të realizojë shitjen me ankand publik të mjeteve të transportit të rëndë që nuk plotësojnë kushtet për qarkullim, të destinuara për t'i trajtuar si skrap, sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. DPRMSH-ja, për llogaritjen e vlerës fillestare monetare të ankandit, sipas pikës 4 të këtij vendimi, do të bazohet në mesataren e çmimit për kategoritë përkatëse të skrapit, sipas të dhënave të dërguara nga zyra doganore më e afërt.

6. Të ardhurat e përfituara nga shitjet me ankand derdhen në buxhetin e shtetit.

7. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Lidhja nr.1

**LISTA E MJETEVE TË TRANSPORTIT TË RËNDË QË PLOTËSOJNË KUSHTET PËR
QARKULLIM**

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Ngjyra	Viti i prodhimit	Lloji i karburantit	Fuqia motorike
1	Kokë trajleri Scania	FR0185C	Blu	1997	Naftë	12400 cc
2	Kamion Man	KO7078B	Blu	2002	Naftë	S'ka
3	Rimorkio trajleri frigorifer	FR 0089C	E bardhë me shirita	1997	S'ka	S'ka
4	Trailer	KO2615B	Kafe me mbulesë blu	2002	-	-



Lidhja nr. 2

**LISTA E MJETEVE TË TRANSPORTIT TË RËNDË QË NUK PLOTËSOJNË KUSHTET
PËR QARKULLIM DHE QË DO TË TRAJTOHEN PËR SKRAP**

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Ngjyra	Viti i prodhimit	Lloji i karburantit	Fuqia motorike
1	Rimorkio trajleri e hapur	DR 2778 C	S'ka	1986	S'ka	S'ka
2	Rimorkio trajleri Iveco e hapur	S'ka	S'ka	1990	S'ka	S'ka
3	Renault – kokë trajleri	TR 6759 H	E kuqe	1995	Naftë	12000 cc
4	Kokë trajleri Iveco	816AN971	Blu	1990	Naftë	
5	Kamion Benz	TR 8319 A	Blu	1986	Naftë	2800 cc
6	Trailer -Viberti	DR 9928 A	E bardhë	1982	-	-
7	Kokë trajleri - Scania	OF 04043	E bardhë	1988	Naftë	3200 CC
8	Trajler	OF 04030	Denat	1994	-	-
9	Kamion - Fiat	DR 4869 A	Vishnje	1987	Naftë	2800 cc
10	Trailer - Volvo	SH 8322 C	E bardhë	1987	-	-
11	Kokë traileri – M. Benz	LE 2218 A	Denat	1977	Naftë	3200 cc
12	Trailer frigorifer	TR 0306 D	Denat	1992	-	-
13	Betoniere - SAURER	TR 6266 H	Blu e hapur	1985	Naftë	S'ka

VENDIM**Nr. 769, datë 2.11.2016**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN
NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E
PERSONAVE TË SHPALLUR SI
FINANCUES TË TERRORIZMIT”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 15, pika 3, e 18, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas listës së personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (“Lista e OKB-së”), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet nënndarja “Lista e individëve të shpallur sipas procedurës së brendshme të shpalljes”, me përmbajtje sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Zbatimi i këtij vendimi bëhet nga autoritetet përgjegjëse të përcaktuara në nenin 7, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI**Niko Peleshi**

**LISTA E INDIVIDËVE TË SHPALLUR
SIPAS PROCEDURËS SË BRENDSHME
TË SHPALLJES**

1. GENCI BALLA (emri fetar - ABDURRAHIM) - shtetas shqiptar, i biri i Sami dhe Ajrije, i datëlindjes 11.2.1979.

2. BUJAR HYSA (emri fetar – EBU USAMA) - shtetas shqiptar, i biri i Asllan dhe Zoje, i datëlindjes 18.6.1971.

3. GERT PASHJA (emri fetar – EBU MUXHAHID ose MUHAMED), i biri i Isuf dhe Ike, i datëlindjes 9.4.1984.

4. ASTRIT TOLA (emri fetar – ISMAIL), i biri i Hajdar dhe Hamide, i datëlindjes 20.6.1972.

5. VERDI MORAVA, i biri i Dielli dhe Vergjinush, i datëlindjes 14.11.1966

6. ZEQRIR IMERI (emri fetar – ZEKERIA ose ABU YAHJA), i biri i Isuf dhe Shkurte, i datëlindjes 22.2.1980.

7. EDMOND BALLA (emri fetar – ISUF), i biri i Shaban dhe Hanife, i datëlindjes 24.10.1989.

8. FADIL MUSLIMANI, i biri i Adem dhe Aishe, i datëlindjes 26.1.1961



9. ORION REÇI (emri fetar – Enes), i biri i Sami dhe Reme, i datëlindjes 6.9.1977.

10. SHKËLZEN DUMANI (emri fetar – Omer), i biri i Fari dhe Mentije, i datëlindjes 19.9.1975.

11. MEHDI MANALLARI (emri fetar – IBU ABDULAZIZ ALBANI), i biri i Xhafer dhe Safie, i datëlindjes 15.6.1949

12. ALMIR DACI (emri fetar – EBU BELKISA), i biri i Xhevair dhe Nafije, i datëlindjes 1.3.1983

13. SHYQYRI KASA (emri fetar – SHUKRI), i biri i Maliq dhe Zanushe, i datëlindjes 27.5.1966

VENDIM

Nr. 771, datë 2.11.2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 276, DATË 1.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, NGA MINISTRIA E MBROJTJES MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES DHE MINISTRI TË SHETIT PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE, TË PRONËS NR. 33, ME EMËRTIM “SHTËPIA E USHTARAKËVE”, ME VENDNDODHJE NË BULEVARDIN “ZHAN D’ARK”, TIRANË, PËR VENDOSJEN E QENDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT (QKR), QENDRËS KOMBËTARE TË LICENCIMIT (QKL) DHE QENDRËS SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA), SI DHE DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË MARKAVE DHE PATENTAVE (DPPM) E AGJENCISË SË ZBATIMIT TË REFORMËS TERRITORIALE (AZRT), TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 12, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 276, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Në titull dhe në të gjithë tekstin, fjalët “...Qendrës/a Kombëtare të Regjistrimit (QKR), Qendrës/a Kombëtare të Licencimit (QKL)...” zëvendësohen me “...Qendrës/a Kombëtare të Biznesit (QKB)...”.

2. Në titull dhe në pikën 1 bëhen këto shtesa:

a) Pas emërimit “...ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike...” shtohen fjalët “... si dhe Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit (STKKU)...”.

b) Pas emërimit “...Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave (DPPM) e Agjencisë së Zbatimit të Reformës Territoriale (AZRT)...” shtohen fjalët “...dhe Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit (STKKU)”.

3. Në pikën 2 bëhen shtesat si më poshtë vijon:

a) Në fjalinë e parë, pas fjalëve:

i) “...Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes...” shtohen fjalët “...dhe Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit (STKKU)...”;

ii) “...Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave (DPPM)...” shtohen fjalët “...si dhe Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit (STKKU)”.

b) Në fund të shkronjës “a”, të pikës 2, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:


“Kati përdhe të përdoret nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave (DPPM), si dhe Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit (STKKU), sipas planimetrisë bashkëlidhur, që është pjesë përbërëse e këtij vendimi.”.

4. Në pikën 4, pas fjalëve “...ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike...” shtohen fjalët “...ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore dhe Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit...”.

5. Në pikën 5, pas fjalëve “...ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike...” shtohen fjalët “...ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore dhe Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTRI
Niko Peleshi



VENDIM
Nr. 772, datë 2.11.2016

**PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2016, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E ENERGJISË DHE
INDUSTRIË, NË CILËSINË E
ORGANIT TË INTERESUAR, PËR
PAGESËN E FATURAVE TË
AVOKATËVE TË KONTRAKTUAR PËR
PËRFAQËSIMIN DHE MBROJTJEN NË
ÇËSHTJET E ARBITRAZHIT
NDËRKOMBËTAR ICC, NR. 20564/EMT
HYDRO S.R.L. KUNDËR REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE ICSID, NR.
ARB/15/28 HYDRO S.R.L. & OTHERS
KUNDËR REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, DHE ÇDO SHPENZIMI
TJETËR TË LIDHUR ME TO**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008,

“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, në cilësinë e organit të interesuar, në buxhetin e miratuar për vitin 2016 i shtohet kundërvlera në lekë e fondit prej 1 175 000.00 (një milion e njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) eurosh dhe 125 000.00 (njëqind e njëzet e pesë mijë) dollarësh për kryerjen e pagesave të faturave të avokatëve të kontraktuar për përfaqësimin dhe mbrojtjen në çështjet e arbitrazhit ICC, nr. 20564/EMT Hydro S.R.L. kundër Republikës së Shqipërisë dhe ICSID, nr. ARB/15/28 Hydro S.R.L. & Others kundër Republikës së Shqipërisë, si dhe për çdo shpenzim tjetër të lidhur me to, në përputhje me faturat e miratuara



nga Avokatura e Shtetit.

2. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2016.

3. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 775, datë 2.11.2016

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË
FINANCIMIT, NGA BUXHETI I VITIT
2016, PËR KISHËN KATOLIKE NË
SHQIPËRI, ME RASTIN E
LUMTURIMIT TË MARTIRËVE
SHQIPTARË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 2, të ligjit nr. 10140, datë 15.5.2009, “Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkësive fetare tradicionale, që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave”, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2016, në programin “Mbështetje për kultet fetare”, i shtohet fondi prej 3 000 000 (tre milionë) lekësh për financimin e Kishës Katolike në Shqipëri, me rastin e Lumturimit të Martirëve Shqiptarë.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2016.

3. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Komiteti Shtetëror për Kultet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 780, datë 2.11.2016

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA ZBATIMI I
PROJEKTIT “NDËRHYRJE
REHABILITUESE NË ZONËN E
MBROJTUR TË QENDRËS HISTORIKE
TË DHËRMIUT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, në zonën kadastrale nr. 1481, me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi 200 (dyqind) m² dhe sipërfaqe trualli 270 (dyqind e shtatëdhjetë) m², që preken nga zbatimi i projektit “Ndërhyrje rehabilituese në zonën e mbrojtur të Qendrës Historike të Dhërmiut”, miratuar me vendimin nr. 80, datë 13.4.2016, të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve (KKR).

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Vlorë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “truall” dhe “njësi shërbimi”, me një vlerë të përgjithshme 7 464 400 (shtatë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e katërqind) lekë.

4. Vlera totale e shpronësimit, prej 7 464 400 (shtatë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e katërqind) lekësh, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave pranë Bankës së Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.

5. Shpronësimi të fillojë në datën e botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

6. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Kulturës.



7. Pronarët e konfirmuar nga ZVRPP Vlorë, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Vlorë.

8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Vlorë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, të

miratuar nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Vlorë, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

9. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Ministria e Financave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë për ndjekjen e procedurave të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

LISTA E PASURIVE TË PALUAJTËSHME PRONË PRIVATE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR
MARRJEN NË PERDORIM TË PÛRKOHSHËM PËR INTERES PUBLIK , TË CILAT PREKEN NGA
"PROJEKTI PËR NDËRHYRJE REHABILITUESE NË ZONËN E MBROJTUR TË QENDRËS
HISTORIKE TË DHËRMIUT"

Nr	Pronari	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Sipërfaqe (m ²)		Çmimi lekë/m ²		Vlera lekë		SHËNIME
				Truall	Ndërtim	Truall	Ndërtim	Truallit	Njesi	
1	Arete Zaho	1481	28		40.00		32,516	-	1,300,640.00	sipas vërtetimit të pronësisë
2	Thodhori Duni	1481	417/130	270.000	160.00	3,560	32,516	961,200	5,202,560.00	sipas regjistrimit hipotekor
				270.00	200.0	3,560	32,516	961,200	6,503,200	7,464,400
Totali:				7,464,400						

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 252 lekë